

SPITALI SPECIAL PËR TERAPI
FIZIKALE PËR PËRHAFTIMI
"BANJA E KLLOKOTIT" Sh.p.k.
Nr. 27 DE 30.03.2022
VITI - KLLOKOT

BINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
BINDIKAT POLICIJE KOSOVA
KOSOVO POLICE UNION



Nr./Br./No. c/008/22 Nr.faq/Br.str./No.pg. 1

Data/Datum/Date 31.03.2022

PRISHTINË-PRISTINA-PRISHTINE



SPITALI SPECIAL PËR REHABILITIM TË PËRGJITHSHËM
Banja e Kllokotit



MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

E lidhur me datë: 30.03.2022, në Kllokot,
në mes të:

1. SPITALIT SPECIAL PËR REHABILITIM TË PERGJITHSHËM "BANJA E KLLOKOTIT" SH.P.K. të cilën e përfaqëson drejtori Nezir Rexhepi, si ekzekutues – kryes i shërbimeve shëndetësore-fizioterapeutike, në njërën anë dhe
2. Sindikata e Policisë së Kosovës të cilën e përfaqëson kryetari Imer Zeqiri, shfrytëzues i shërbimeve mjekësore fizioterapeutike.

QËLLIMI: Shfrytëzimi i shërbimeve shëndetësore-fizioterapeutike.

Neni 1.

Banja e Kllokotit merr për obligim trajtimin e pacientëve me terapi adekuate fizikale për pacientët – nga Sindikata e Policisë së Kosovës të cilët vijnë me vërtetim-vendim nga Sindikata e Policisë së Kosovës.

Neni 2.

Çmimi i pansionit për një person-pacientë nga Sindikata e Policisë së Kosovës është 19,00 euro ku në pansion hyn; kontrollimi mjekësor, fjetja, ushqimi dhe terapitë, me këtë çmim mund të vendosen edhe bashkëshorti-ja e Policit nga Sindikata, por që pagesa për bashkëshortin-en bëhet në momentin e vendosjes. Pagesa për Sindikatën e Policisë së Kosovës nga Sindikata bëhet pas qëndrimit në Banjë, pagesa bëhet nga Sindikata e Policisë.

Neni 3.

Koha për vendosje dhe qëndrim në Banjë caktohet me marrëveshje në mes të dy subjektëve kontraktues respektivisht shefit të recepcionit dhe shfrytëzuesit të shërbimeve. Pacienti me rastin e ardhjes në Banjë duhet të ketë me vete vërtetimin-vendimin e Sindikatës për dërgim në Banjë të Kllokotit. Marrëveshja lidhet për kohë të caktuar prej datës 01.04.2022, e deri me date 31.03.2023. Palët mund të kërkojnë shkëputjen e kontratës pasi të ketë njoftuar një muaj më parë.

Neni 4.

Palët kontraktuese mos marrëveshjet do ti zgjidhin me dialog e mirëkuptim e në rast mos zgjidhje me mirëkuptim, kompetent për zgjidhje është Gjykata Themelore në Gjilan Dega në Viti.

Neni 5.


Marrëveshja është e përpiluar në katër (4) kopje identike, ku palët do ti marrin nga dy kopje.

Për Sindikatën e Policisë së Kosovës


Imer Zeqiri



Për Banjën e Kllokotit


Nezir Rexhepi

